



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 27-56/2019 regjistri (JR)
Datë 19.12.2024

Nr. 68 i vendimit
Datë 24.03.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Mimoza Tasi	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në datën 24.03.2026, në orën 16:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, me sekretare gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen që i përket:

KËRKUES: Ardian Ylli, i datëlindjes {***}, lindur në Korçë dhe banues në lgj. nr. {***}, Durrës; e-mail: {***}; tel: {***}, përfaqësuar me prokurë të posaçme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.12.2024 nga avokati Renaldi Meka, me adresë: rruga “{***}”, {***}, kati {***}, zyra nr. {***} Tiranë; Email: {***}; tel: {***}.

OBJEKTI: Rishikimi i vendimit nr. 25, datë 29.07.2021, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, pika 1, 5, 6, 7, 15, 42 dhe 116, pika 1, 122 dhe 124, të Kushtetutës; Neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut; Nenet 494-498/a të Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, analizoi pretendimet e z. Ardian Ylli në kërkesën për rishikim, i cili përfundimisht kërkoi rishikimin e vendimit nr. 25,

datë 29.07.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes, Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Z. Ardian Ylli (në vijim “kërkuesi”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”). Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 182, datë 18.07.2019, ka vendosur *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ardian Ylli me detyrë prokuror/ drejtues i komanduar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*.
2. Ndaj vendimit të sipërcituar, paraqiti ankim në Kolegj subjekti i rivlerësimit Ardian Ylli. Trupi gjykues i Kolegjit, (në vijim trupi gjykues), pas shqyrtimit të ankimit, si dhe pasi analizoi shkaqet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, shqyrtoi provat dhe aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se: “... subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi nga analiza financiare për vitet 2004, 2006, 2008, 2010 – 2015, rezultoi se subjekti nuk provon aftësinë financiare për të justifikuar me të ardhura të ligjshme shpenzimet e kryera në këto vite, duke rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016” dhe, me vendimin nr. 25, datë 29.07.2021, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 182, datë 18.07.2019, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ardian Ylli”.
3. Kërkuesi ka paraqitur në Kolegj kërkesën për rishikimin e vendimit të Kolegjit (JR) nr. 25, datë 29.07.2021, në të cilën pretendon se gjendet përballë disa rrethanave të reja, të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 494 dhe 495, të Kodit të Procedurës Civile (në vijim “K.Pr.Civile”)¹, për rishikimin e vendimit.

II. Pretendimet e kërkuesit

4. Kërkuesi sjell në vëmendje se më datë 04.10.2022, GjEDNj-ja ka dhënë vendimin për çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, ku ka vendosur se ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me të drejtën e kërkuesit (Besnik Cani) për një “gjykatë të krijuar me ligj”. Sipas kërkuesit ky është një vendim të cilit gjykatat duhet t’i referohen në trajtimin e çështjeve të ngjashme që lidhen me të drejtat e njeriut, për shkak të

¹ Neni 494: Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: b) vërtetohet se thëniet e dëshmitarëve apo mendimet e ekspertëve, mbi të cilat është bazuar vendimi, kanë qenë të rreme; c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit; ç) vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara.

Neni 495: Rishikimi i vendimeve për rrethanat e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 494 të këtij Kodi lejohet kur ato rrethana janë vërtetuar me vendim penal të formës së prerë.

rolit që ka KEDNj-ja dhe vendimet e GjEDNj-së në sistemin juridik të brendshëm, referuar nenit 17 dhe 116 paragrafi 1, si dhe nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

4.1. Së pari, kërkuesi argumenton se gjyqtari A. H., anëtar i trupit gjykues që shqyrtoi vendimin e dhënë ndaj tij nga Komisioni, është dënuar me vendim të formës së prerë², për veprat penale "Fshehje e të ardhurave" e parashikuar nga neni 180, i Kodit Penal, si dhe "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", parashikuar nga neni 257/a, i Kodit Penal, e për rrjedhojë, pavarësisht se ky anëtar nuk ishte i dënuar në kohën e emërimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nëse veprimet e kundërligjshme të tij do të zbuloheshin në kohën e emërimit ose gjatë ushtrimit të mandatit, ai nuk do të plotësonte kriteret për të qenë gjyqtar ose mandati i tij do të ishte ndërprerë. Ndodhur në këto kushte, sipas kërkuesit, ky anëtar i trupit gjykues nuk përmbushte kriteret për të qenë gjyqtar, e për rrjedhojë prania e tij në trupin gjykues që ka gjykuar çështjen ndaj subjektit të rivlerësimit Ardian Ylli ka sjellë cenim të procesit të rregullt ligjor.

4.2. Së dyti, sipas kërkuesit, ka lidhje indirekte të veprës penale të kryer nga anëtari i trupit gjykues dhe vendimit të dhënë ndaj subjektit të rivlerësimit, pasi në kushtet që anëtari i trupit gjykues është dënuar për veprime të kundërligjshme lidhur me deklarimin e pasurisë së tij pranë ILDKPKI-së, nuk mund të konsiderohet se mund të gjykonte drejt dhe objektivisht po mbi kriterin e pasurisë subjektin e rivlerësimit dhe të vendoste për shkarkimin e tij.

4.3. Së treti, gjyqtari A. H. nuk ka qenë anëtari i vetëm i trupit gjykues për gjykimin e çështjes së subjektit të rivlerësimit ky fakt nuk mund të justifikojë shkeljen e procesit të rregullt ligjor, i cili kërkon jo vetëm gjykimin nga një gjykatë e krijuar me ligj por edhe një gjykim të paanshëm dhe të drejtë.

4.4. Për sa më sipër, kërkuesi bazuar në nenin 494, shkronja "c" të K.Pr.Civile ka kërkuar rishikimin e vendimit nr. 25, datë 29.07.2021, të Kolegjit.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Procesi gjyqësor në Kolegji

Juridiksioni i Kolegjit

5. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2, të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (ratione materiae) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, sipas pikës 3 të këtij neni, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe

² Me vendimin nr. {***} ({***}-2024-{***}), datë 18.11.2024, të Gjykatës së Apelit për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin.

Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

6. Në vijim të sa përmbledhet më sipër, rezulton se i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim të shprehur literal, së pari, për të drejtën procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim të subjekteve të rivlerësimit brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi, dhe së dyti, as për ndonjë kompetencë të Kolegjit që ushtrohet tej funksionit kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.
7. Për shkak të kësaj baze ligjore dhe jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues lidhur me kërkimin në rastin konkret, nënvizon qëndrimin se Kolegji mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuesit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e K.Pr.Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së.
8. Trupi gjykues, pasi analizoi përmbajtjen e kërkesës për rishikim, konstatoi se ajo formalisht bazohej në nenin 494, shkronja “c” e K.Pr.Civile, referim i cili përcaktoi edhe analizën e trupit gjykues që i atribuohet këtij shkaku rishikimi, e cila do të trajtohet në vijim të këtij arsytimi.
9. Në vijim të arsytimit mbi juridiksionin e Kolegjit, trupi gjykues sjell në vëmendje vendimin nr.12, datë 19.04.2024 të Kolegjit, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuesit Artor Ylli, në të cilin është arritur në konkluzionin se dispozitat e Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, parashikojnë dhe përcaktojnë në mënyrë të shprehur vetëm juridiksionin rivlerësues të Kolegjit lidhur me kontrollin ndaj vendimeve të marra prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, juridiksion i ushtruar mbi ankimin e subjekteve të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik. Më tej në këtë vendim është arsyetuar se nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim eksplisit për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas kërkesës së parashikuar prej kërkuesit, në çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e rregullave për trajtimin e kërkesave të tilla, diktoi nevojën e analizimit nga trupi gjykues i çështjes së cituar më sipër, të dispozitave që thirren për zbatim nga ligji nr. 84/2016, nëse nëpërmjet tyre mund të ushtrohej ky juridiksion rishikues i pretenduar nga kërkuesi.
10. Në vijim të sa më sipër, në nenin 4, pika 6, e ligjit nr. 84/2016, nuk parashikohet në mënyrë të shprehur asnjë rregull për institutin e rishikimit, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, duke ndjekur të njëjtën logjikë, në zbatim të nenit 1, pika 2, e ligjit nr. 49/2012, sipas së cilit dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe. Në vendimin e cituar në paragrafin më sipër, është marrë në analizë, nëse ndërtimi i këtij mekanizmi kontrolli të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë vjen në përputhje me qëllimin e legjislatorit edhe në rastin konkret, lidhur me tagrat e atribuuar organeve të rivlerësimit dhe posaçërisht Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit në vendimin e referuar më sipër, por edhe në vendimet e marra më pas që kanë shqyrtuar kërkesa të ngjashme për rishikimin e vendimeve të Kolegjit, ka arritur në

konkluzionin se Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenet 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

11. Në zbatim të parashikimit të nenit 116, pika 1, germa “b” e Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara bëjnë pjesë në aktet normative që kanë fuqi në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke u renditur në hierarkinë e ligjeve pas Kushtetutës së vendit. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut së bashku me mekanizmat e saj zbatues, garanton zbatimin e parimit të procesit të rregullt ligjor nga gjykatat e brendshme, por edhe të parimeve të tjera që parashikon Konventa, në përputhje me nenet 17 e 42, të Kushtetutës. Parashikimi i nenit F, pika 8, e Aneksit të Kushtetutës, konsiderohet si i vetmi mjet procedural që kanë në dispozicion subjektet e rivlerësimit, në rast se të drejtat e tyre shkelen nga Kolegji në gjykimin e çështjeve të tyre dhe si e vetmja mundësi për të korigjuar çdo gabim gjyqësor që mund të jetë konstatuar. Ky parashikim drejton subjektet drejt GjEDNj-së, duke konfirmuar natyrën e jashtëzakonshme të procesit, përjashtimin nga rregullat e zakonshme procedurale dhe orientimin për adresimin në këtë gjykatë, të çdo problematike që është konstatuar përgjatë procesit e që ka çuar edhe në ndonjë gabim gjyqësor. Si rrjedhojë, subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Kolegjit në GjEDNj për çdo rast që ata konsiderojnë se vendimmarrja ndaj çështjes së tyre të rivlerësimit, është në shkelje të parashikimeve të Konventës dhe Protokolleve të saj, të mbrojtura në Kushtetutë, për shkak të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare që edhe Shqipëria është palë.
12. Në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, në germën “ë”, parashikohet se pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Sipas këtij parashikimi, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GjEDNj-ja në sistemin tonë juridik ka një kompetencë ekskluzive. Kushtetuta në nenin 122, përcakton epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin juridik të brendshëm dhe sjell si detyrim që vendimet e GjEDNj-së të zbatohen drejtpërsëdrejti nga të gjithë organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjithë niveleve, po ashtu, edhe gjykatat me juridiksion specifik siç është Kolegji. Gjithashtu, procesi i rivlerësimit kalimtar vëzhgohet dhe monitorohet nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, parashikuar nga kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit. Roli dhe kompetencat e këtij organizmi jo vendimmarrës janë garanci e shtuar për mbrojtjen e interesave të subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit dhe kryerjen e tij në respektim të parimeve të procesit të rregullt ligjor. Sa më sipër, për sa kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit, si dhe institucionet që e kryejnë atë, japin garanci maksimale për të shmangur shkaqet e parashikuara në 6 germat e para të nenit 494, të Kodit të Procedurës Civile, vlerësohet se jo pa qëllim kushtetutëbërësi ka parashikuar ankimin ndaj vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në GjEDNj. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga leximi harmonik i nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji do të kishte juridiksion rishikues vetëm mbi bazë të një vendimi të GjEDNj-së që potencialisht do të konstatonte se ekzistojnë shkaqet që përlligjin shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të tij, nëpërmjet rihapjes së procesit, për të rivendosur të drejtën e cenuar.

13. Në përfundim, sipas analizës harmonike dhe të gjithanshme të dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, si dhe orientimeve të instrumenteve ndërkombëtare, që kanë normuar procesin e rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të Vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuesit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8, e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së.
14. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
15. Për sa më sipër, lidhur me pretendimin e kërkuesit, mbështetur në faktin e dënimit të gjyqtarit A. H., si një ndër rrethanat e rishikimit të vendimit bazuar në nenin 494, shkronja “c” e K.Pr.Civile, trupi gjykues vëren se fakti që në rastin konkret vepra penale që pretendohet se është kryer nga z. A. H. para se ai të zgjidhet në funksionin e gjyqtarit të Kolegjit dhe nuk lidhet me procesin e zgjedhjes së tij në këtë detyrë, shkaput çdo lidhje logjike dhe shkakësore midis dhënies së vendimit për të cilin kërkohet rishikimi dhe veprës penale. Për rrjedhojë, nuk vlerësohet se gjen zbatim neni 494, germa “c” e K.Pr.Civile, siç është elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit edhe në çështje të tjera.
16. Trupi gjykues, pa përsëritur sa është arsytuar gjerësisht nga Kolegji në trajtimin e kërkesave me të njëjtën natyrë e objekt, si dhe duke ndjekur të njëjtën analizë sistematike të dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, dhe sipas orientimeve të instrumenteve ndërkombëtare, që normojnë parimet mbi të cilat zhvillohet edhe procesi i rivlerësimit kalimtar, rikonfirmon vlerësimin që në kushtet që nuk ka një vendim nëpërmjet të cilit GjEDNj-ja të ketë konkluduar për shkelje të kryer në procesin e rivlerësimit të kërkuesit, kërkesa e tij për rishikim nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkuesi bën në nenin 494, germa “c” të K.Pr.Civile.
17. Së fundmi, ndonëse shkak i rishikimit i paraqitur prej kërkuesit, nuk i nënshtrohet juridiksionit rishikues të Kolegjit sipas arsytimit të mësipërm, sërish ai, sipas një analize *obiter dictum*, konstatohet se edhe nëse do t’i nënshtrohej shqyrtimit gjyqësor, do të konsiderohej i pabazuar në fakte dhe në ligj, pasi mungon lidhja shkakësore mes vendimmarrjes së gjyqtarit A. H. në çështjen e rivlerësimit të kërkuesit dhe veprës penale për të cilën ai është deklaruar fajtor. Parashikimet ligjore që lidhen me rishikimin në asnjë rast nuk u referohen ndodhive, fakteve apo rrethanave, të cilat nuk rrjedhin apo paraprijnë, ose janë shkak për marrjen e vendimit për të cilin kërkohet rishikimi. Nga ky lexim rezulton se, në mënyrë që vepra penale për të cilën anëtari i trupit gjykues është gjetur fajtor të ketë ndikuar në dhënien e vendimit, pala kërkuese duhet të provojë lidhjen shkakësore mes veprës penale dhe vendimit të atakuar nëpërmjet rishikimit, ose që në momentin kur gjyqtari ka marrë vendimin, vullneti i tij është vesuar për shkak të kësaj vepre penale, duke ndikuar në vendimmarrjen objekt rishikimi. Të tilla raste do të ishin sjelljet e një gjyqtari në shkelje të parimeve të paanësisë dhe objektivitetit, provuar nga

një vendim penal i formës së prerë. Një analizë e kryer duke aplikuar këto parime, është në linjë edhe me jurisprudencën e GjEDNj-së, shtjelluar në drejtim të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë që diktojnë parimet e nenit 6/1 të Konventës, si në çështjen *Brumarescu*, ku është elaboruar që cenimi i një vendimi përfundimtar mund të legjitimohej vetëm për të korrigjuar një “dështim të drejtësisë”³. Për rrjedhojë, nuk vlerësohet se do të gjente zbatim neni 494, germa “c” e K.Pr.Civile, edhe nëse kjo kërkesë do t’i nënshtrohej shqyrtimit, siç është elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit edhe në çështje të tjera.

18. Për sa më lart, trupi gjykues arriti në përfundimin se kërkesa për rishikim e paraqitur prej z. Ardian Ylli, është e pabazuar në fakte dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji, bazuar në nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së kërkuesit Ardian Ylli, për rishikimin e vendimit nr. 25, datë 29.07.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 24.03.2026.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

³ Shih “*Brumarescu kundër Rumanisë*”, “*Pravednaya kundër Rusisë*” prg. 25, “*Bratyakin kundër Rusisë*”, ndër të tjera.

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e anëtares, jam dakord me zgjidhjen e çështjes në vendimin nr. 68, datë 24.3.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit Ardian Ylli për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 25 (JR), datë 29.07.2021, të Kolegjit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës, por kam ndarë mendim ndryshe sa i përket qëndrimit të mbajtur lidhur me arsyetimin për mungesën e juridiksionit rishikues⁴ të Kolegjit për shqyrtimin e kërkesave që nuk kanë një vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas shkronjës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.
2. Në vlerësimin tim, Kolegji ka juridiksion rishikues për shqyrtimin e kërkesave për rishikim vendimi që janë paraqitur bazuar në nenin 494⁵, shkronja “c”⁶ të Kodit të Procedurës Civile dhe argumentet e mia kundërshtuese për mungesën e juridiksionit rishikues, janë shprehur në mënyrë shteruese dhe konsistente në një sërë vendimesh ku janë shqyrtuar kërkesat për rishikim vendimi, duke mbajtur një qëndrim ndryshe, shprehur nëpërmjet mendimeve paralele⁷ apo mendimeve të pakicës⁸.
3. Një interpretim nga Kolegji që pranon rishikimin vetëm pas vendimit të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të kërkuarit (subjekt rivlerësimi), e bën juridiksionin rishikues të varur vetëm nga gjykata e Strasburgut, duke hequr mundësinë e çdo mekanizmi korigjues të brendshëm dhe duke krijuar një vakum juridik për shkelje serioze që nuk kanë arritur ende në GjEDNj.
4. Pranimi i juridiksionit rishikues vetëm në mënyrë minimaliste dhe vetëm për vendimet e GjEDNj-së, në vlerësimin që i bëj çështjes, duket se krijon një kontradiktë logjike, sepse e bën rishikimin një “mjet të jashtëm” dhe jo “mjet të brendshëm”, duke lënë pa zgjidhje gabimet serioze të brendshme që përbëjnë shkaqet e rishikimit sipas shkronjave të tjera të nenit 494 të Kodit. Pra, nëse rishikimi do të ekzistojë vetëm pasi GjEDNj-ja të shprehet me një vendim të

⁴Ky qëndrim është mbajtur nga shumica e trupës gjyqësore në vendimin nr. 12, datë 19.4.2024, që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuarit A. Y., regjistruar me nr. 2-4/2019 regjistër (JR), datë 10.1.2022, me objekt “Rishikimi i vendimit të formës së prerë nr. 31 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, në të cilin nuk kam qenë anëtare e trupit gjyqësor.

⁵Neni 494 i KPrC: “Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: ë...](c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjyqësor, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit; ë...](ë) kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

⁶ Në vendimin e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, që i përket kërkuarës R. G., me mendim paralel, jam shprehur që kërkesa e katërt, për rishikimin e vendimit nr. 12/2019 të Kolegjit, sipas shkronjës “c” të nenit 494, është e bazuar dhe përbën shkak për rishikimin e vendimit përfundimtar.

⁷ Vendimi i Kolegjit nr. 9, datë 28.2.2025, që i përket kërkuarit A. B.; Vendimi i Kolegjit nr. 18, datë 8.5.2025, që i përket kërkuarit A. Gj., etj.

⁸ Vendimi i Kolegjit nr. 19, datë 08.05.2025, që i përket kërkuarit R. T.; Vendimi i Kolegjit nr. 49, datë 11.03.2026, që i përket kërkuarit B. H.; Vendimi i Kolegjit nr. 54, datë 24.03.2026, që i përket kërkuarit G. T., etj.

posaçëm për kërkuesin (subjekt rivlerësimi), kjo do të passillte që mjete i brendshëm të mos jetë efektiv⁹ dhe kjo mund të çojë në shkelje të nenit 13¹⁰ të KEDNj-së.

5. Në lidhje me kërkesën e kërkuesit Ardian Ylli, paraqitur më datë 19.12.2024, rezulton se: (i) shkak për rishikim, sipas pretendimit të kërkuesit përbën vendimi gjyqësor i shpallur më datë 18.11.2024 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr. {***} ({***}-2024-{***}), që ka dënuar me vendim të formës së prerë¹¹ gjyqtarin A. H.; (ii) parregullsitë në emërimin e gjyqtarit A. H. kanë cenuar të drejtën për t'u gjykuar para një gjykate të krijuar në përputhje me ligjin, referuar vendimin e GJEDNJ-së Besnik Cani kundër Shqipërisë; (iii) kërkesa bazohet në nenin 494, germa “c” të Kodit të Procedurës Civile dhe është paraqitur në afat.
6. Sa i përket kësaj kërkesë, vlerësoj se kërkuesi i është referuar vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i cili edhe pse është një vendim i formës së prerë, nuk përbën një vendim përfundimtar, në kuptim të *res judicata*. Nga burime të hapura, rezulton që ky vendim të jetë rekursuar në Gjykatën e Lartë, e cila ende nuk ka mbajtur një qëndrim për rekursin.
7. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues nr. 2, datë 03.11.2014, në trajtimin e çështjes së referuar, i kanë bërë një interpretim të qartë e të plotë kuptimit që duhet të ketë termi “vendimi i formës së prerë”, për efekt të gjësë së gjykuar, duke plotësuar mungesën e një përkufizimi juridik të Kodit të Procedurës Penale, lidhur me shprehjen “vendim i formës së prerë” dhe se si duhet të konsiderohen nocionet “vendim i ekzekutueshëm”, “vendim i formës së prerë” dhe “gjë e gjykuar”. Kështu, në paragrafin 26 të vendimit, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin se: “26. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se duhet rikonfirmuar pohimi sipas të cilit rekursi në Gjykatën e Lartë përbën mjet të zakonshëm ankimi, shterimi i të cilit e kthen vendimin në formë të prerë në kuptimin e “gjësë së gjykuar [...]”.
8. Referuar vendimmarrjes unifikuese që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sa kohë që ndaj rekursit të gjyqtarit A. H., deri në momentin e gjykimit të kësaj kërkesë, nuk ka ende një vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që të ketë shteruar rekursin, si mjet të zakonshëm ankimi, për pasojë, dënimi penal nuk ka marrë formë të prerë në kuptim të “gjësë së gjykuar”.

⁹ Çështja “Scordino v. Italy (No. 1) (GC, 2006) (Application no. [36813/97](#)) - <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-72925>”.

¹⁰ Neni 13 i KEDNj-së: “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

¹¹ Gjyqtari A. H. është dënuar për veprat penale “Fshehje e të ardhurave” dhe “Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, parashikuar nga nenet 180 dhe 257/a të Kodit Penal.

9. Në këto kushte, kërkesa e paraqitur nga kërkuesi, e bazuar në një vendim të Apelit, që nuk ka marrë formë të prerë, në kuptim të “gjësë së gjykuar”, në koherencë me qëndrimet e mia të mëparshme, vlerësoj se nuk përmbush kushtet e pranueshmërisë nga ana formale, sipas parashikimeve të nenit 495 të Kodit të Procedurës Civile.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam dakord me vendimin nr. 68 (JR), datë 24.03.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për: *“Mospranimin e kërkesës së kërkesit Ardian Ylli, për rishikimin e vendimit nr. 25/2021 (JR), datë 29.07.2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me arsyetimin se nga interpretimi i dispozitave të Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim të shprehur për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit. Procesi i rivlerësimit, duke qenë sui generis, me mandat në kohë të kufizuar dhe rregulluar me një kuadër kushtetues e ligjor të posaçëm, e bën të pazuar kërkesën për rishikim të paraqitur nga kërkuesi.*
2. Në cilësinë e gjyqtares me mendim paralel, ndaj qëndrim ndryshe nga shumica trupit gjykues, e cila arsyeton se: *“[...] Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t’i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenin 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve, në të cilat gjen zbatim germa “ë” e nenit 494, për shkak të një vendimi të shprehur të GjEDNj-së në trajtimin e një ankimi. [...], trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkueses, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile, dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së”.*
3. Në vlerësimin tim, si gjyqtare me mendim paralel, ky arsyetim nuk qëndron, pasi vjen si pasojë e një interpretimi të pabarabartë të situatave juridike të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke i atribuar Kolegjit mundësinë e rishikimit vetëm për rastin e parashikuar nga shkronja “ë” e kësaj dispozite: *“Kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane ‘Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore’ dhe të Protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”.*
4. Në mungesë të një parashikimi kushtetues dhe ligjor që t’i atribuojë Kolegjit juridiksion rishikues, kërkesa e rishikimit ndaj vendimit të tij nuk mund të pranohet. Në këto kushte, në vlerësimin tim, mbetet detyrë e ligjvënësit, për të rregulluar këtë situatë të krijuar, duke plotësuar kuadrin ligjor aktual, me qëllim përcaktimin e gjykatës kompetente dhe procedurat ligjore respektive për kryerjen e rishikimit të vendimeve të Kolegjit, të kërkuara nga subjektet e rivlerësimit.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi